



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 03 dhjetor 2019, në mbledhjen e XIX-të (nëntëmbëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.31 dhe filloi në orën 13;35.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS.

### Rendi i ditës

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe njoftuar rreth pikave të rend të ditës, shtoi, thirrjen dhe materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë, por nëse ndokush ka diçka urdhëroni.

**z.Mirsad Kamerolli,** drejtor DPZHE, theksoi, siç kemi diskutuar në periudhën kohore sa ka qenë Draft Strategjia e Turizmit në diskutim publik, afati kohor i kalon sot, për këtë arsyeje nuk e kemi shpërnda materialin e diskutimit publik me ndryshimet që janë bërë sa i përket kësaj strategjie por e kemi lënë sot që këtë mbledhje të KPF-së ta propozojmë si pik shtesë për seancën radhës.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, pasi që materiali i raportit qenka i gatshëm, ju lutem ta shpërndani anëtarëve të KPF-së në mënyrë që nëse mbështetet në votim të hynë si pikë re e rendit të ditës për miratim në seancën e radhës.

**z.Zaim Thaqi,** drejtor i DSHMS, për kundër rrjedhave dhe dinamikës së punës kemi arrit t'i ndërtojmë 20 shtëpi në Lagjen e Dëshmorëve për rastet sociale në mënyrë që të vazhdohet nxjerrja e atyre familjeve nga kontejnerët. Komisioni i cili është ngritur nga ky Kuvend e ka kryer punën e tij, ka nxjerrë një listë, dhe ka një rekomandim, mirëpo kur e kemi shikuar mirë pjesën e Ligjit përkatës dhe të Udhëzimit Administrativ kemi vërejtur që komisioni ka edhe disa obligime tjera, në fakt lista i rekomandon Kuvendit për të vazhduar më tutje me këtë çështjen deri tek lidhja e kontratave me përfituesit. Gjithashtu përveç kontratës kemi edhe një çështje që komisioni e ka për obligim të rekomandoj, fjala është kuotën e pagesës së qirasë që do të thotë se sipas ligjit përfituesit e banimit social janë të obliguar të paguajnë edhe një qira. Ne e kemi konsultuar bashkërisht edhe me zyrën ligjore por edhe në takim me komisioni kemi shqyrtuar të gjitha përgjegjësit që ndërlidhen me komisionin, por që ka dal se kompetencat e komisionit kalojnë edhe përtej nxjerrjes së një liste të përfituesve por deri te

rekomandimi Kuvendit të Komunës, mirëpo ekskluzivisht neve na intereson dhe unë sot po kërkoj nga ju që të mbështetet futja në rendin e ditës për Kuvend, nxjerrja e një kuote për qira të atyre banesave përkatësisht atyre shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, gjë për të cilën besoj që sot është disponimi i të gjithëve, por ekskluzivisht i Kryetarit të Komunës por edhe i komisionit dhe të gjithë akterëve tjerë që kuota të jetë zero euro. Siç jemi në dijeni deri më tani janë 70 familje që janë bërë me shtëpi, që janë nxjerr prej atyre kontejnerëve dhe nuk kanë paguar asnjë kuotë për qira, andaj njëjtë po mendojmë edhe për këto 20 shtëpi, por që kontratën duhet ta nxjerrim brenda javës për 90 përfituesit e atyre shtëpive për shfrytëzim të përkohshëm. Ajo çfarë dua të them është se komisioni e ka për obligim të merr mbështetjen edhe për kohëzgjatjen e shfrytëzimit të atyre shtëpive dhe kemi rënë dakord që kohëzgjatja e tyre të jetë e pa limituar dhe e pa caktuar deri sa të rregullohet statusi i tyre social. Nëse ju e vlerësoni që kjo të kaloj, për hir të rrethanave por edhe për hir që 20 shtëpi janë të gatshme për tu futur në to po aq familje të cilat madje janë përzgjedh nga Komisioni, tani duhet të mbështet edhe nga Kuvendi i Komunës ngase ligji përkatës e përcakton ashtu, prandaj do të kërkoja nga ju që ta miratoni këtë kërkesë fillimisht në këtë mbledhje përkatësisht ta dërgojmë në Kuvend si pikë shtesë, natyrisht pas diskutimeve dhe sqarimeve në tërësi edhe të miratohet një gjë e tillë, pastaj barrën kryesore do ta ketë komisioni që ti procedoj kërkesat që janë në kompetencë të tyre.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, konsideroj se të gjithë e kuptuam qartë propozimin e drejtorit parafolës, më sakt fjala ishte rreth një kontrate që duhet të lidhet mes Komunës dhe përfituesit - shfrytëzuesit të shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc, kontratë e cila sa kuptova duhet të jetë pa afat, të caktohet kuota e qirasë që ishte propozimi të mbetet zero euro dhe çështjeve tjera të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.

**z.Zaim Thaqi,** Drejtor i DSHMS, theksoi, sqarim shtesë, është disponim i të gjithëve e veçanërisht i Kryetarit të Komunës, i Komisionit dhe i të gjithë atyre që janë të ndërlidhur me këtë çështje, që kuota e qirasë së banimit të zero euro. Pastaj është e rregulluar që norma e kuotës së qirasë të jetë jo më shumë se 4% e shumës së investuar. Ne fillimisht kemi menduar që të caktojmë një përqindje minimale të qirasë, mirëpo administrimi i atyre shtëpive nuk ka për mision profitin por janë qira jo profitabile, pra nuk përfiton askush nga qiraja, por ato mjete destinohet për administrimin e asaj lagjeje në aspektin e mirëmbajtjes, mirëpo sërish e them që kjo çështje mbetet edhe në disponimin e të gjithëve që qiraja e banimit të mbetet zero euro deri në një vendim tjetër.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, po ashtu u kuptuam se komisioni përkatës i formuar nga Kuvendi ka nxjerr një listë të përfituesve dhe puna e tyre paska përfunduar, por tani për tu realizuar deri në fund kjo çështje qenka e duhur që komisioni përkatës përmes Drejtorisë përkatëse të sjell në Kuvend kuotën e qerasë e cila siç u tha është mirë të mbetet zero euro, si dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të atyre shtëpive.

**z.Faik Muçiqi,** Drejtor i DSHPMSH, rreth kësaj çështjeje pyeti Kryesuesin për emërtimin e sakt të kësaj pike të propozuar.

**z.Avni Fetahu,** theksoi, ka të drejtë drejtori parafolës z.Faik Muçiqi që parashtrij pyetje rreth propozimit konkret sepse ne nuk jemi këtu për të votuar rekomandim e as disponim të askujt, apo sa dhe si do të jetë qiraja e banimit, por jemi për një pikë të qartë. Pra mund të thuhet, shembull, propozoj që si pikë shtesë e rendit të ditës të hyn edhe propozimi që taksa e qirasë të jetë zero euro.

**z.Zaim Thaqi,** drejtor i DSHMS, theksoi, besoj se kjo çështje ishte e qartë. Ne propozojmë që si pikë e rendit të ditës të hyj rekomandimi dhe raporti i komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, i nderuar drejtor i DSHMS, sipas asaj që ju e potencuat, do të thotë kërkohet që raporti dhe rekomandimi i juaj, të përfshihen si pikë shtesë në rend të ditës në mënyrë që këshilltarët të jenë të informuar dhe të ketë material për të diskutuar dhe miratuar eventualisht në këtë mbledhje dhe në mbledhjen e Kuvendit.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, theksoi, praktikat e komisioneve të ngritura nga Kuvendi, për çështje të caktuara, nuk janë që ata të sjellin raporte dhe rekomandime me shkrim, por është hera e parë pothuajse, por ne nuk jemi mirë me kohën, pastaj edhe komisioni nuk ka qenë mirë i njohur me detyrat dhe obligimet që është ngarkuar por ka menduar që puna e tyre është vetëm për çështje teknike por që ata duhet të bëjnë raporte dhe rekomandime.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, besoj që komisioni e ka përfunduar punën e vetë që e ka pasë, përkatësisht ka bërë listën e përfituesve për ndarjen e shtëpive të banimit dhe të njëjtën ja ka rekomanduar Drejtorisë përkatëse.

**z.Rafet Llapshtica**, theksoi, komisioni në fjalë nuk është ngritë për të liruar apo ngarkuar dikë me taks, komisioni vetëm e bënë përzgjedhjen e familjeve se kush do të vendoset në ato shtëpia të banimit, ndërsa projektionin, legjislacionin e kategorisë sociale, propozimin që të lirohet dikush nga qiraja, taksa, tatimi në pronë etj e bënë Drejtoria përkatëse, përkatësisht Ekzekutivi i Komunës.

Komisioni ka diskutuar absolutisht për t'i liruar nga qiraja sepse atyre familjeve iu ndërtohen shtëpitë për shkak se nuk kanë shtëpi banimi, mirëpo drejtori i DSHMS ka ardh i pa përgatitur në këtë takim dhe po thotë që nuk kemi kohë. Drejtori në fjalë duhet të përgatit skemën sociale, madje është mirë edhe prej tatimit në pronë të lirohet kategoritë përkatëse. Skema sociale nuk paguan asgjë e që në këtë rast dokumentet duhet ti keni vetë ju, e jo komisioni. Këshilltari z.Agim Maqani është kryesues i komisionit dhe kur ai të thotë fjalën e vetë në emër të komisionit sigurisht që ne ja japim mbështetjen, por dokumentet duhet të jenë të gatshme në Drejtori. Pra të sjellët lista e përfituesve, pastaj është afati kohor edhe për ankesa, kemi organin që i shqyrton ato, andaj është mirë të përfundoj kjo procedura sa më shpejt të jetë e mundur.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, si procedurë është mirë ne ta fusim si pik shtesë në rend dite, pastaj secili sipas radhës sqaron punën e vetë. Nëse e shohim të udhës ne i fusim këto dy pika që u propozuan për Kuvend, pas shqyrtimit dhe dhënies së pëlqimit nga KPF.

*Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, duke përfshirë edhe pikat shtesë të propozuara, përkatësisht :*

- **Raporti mbi diskutimin publik të draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës**, propozim i z.Mirsad Kamerolli, drejtor Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.
- **Raporti dhe rekomandimi i Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc**, propozim i z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

## **1. Propozim Plani Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Podujevës, 2019 – 2022**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, unë sapa u informova se dy zyrtarët Liman Zeqiri dhe Ylber Salihu që munden ta arsyetojnë këtë plan nuk janë të gatshëm me ardh në këtë mbledhje. Ky plan që na është sjell është hartuar nga Ministria përkatëse, si model, dhe është i ngjashëm për të gjitha komunat, dhe si tillë mendoj se është mirë të miratohet deri në fund të këtij viti, arsyeja është që të reflekton dhe realizon ato kërkesa që kanë ndikim edhe anëtarësimin e Kosovës.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, zbatimi i këtij plani ka kosto, dhe tani shtroj pyetje, kjo kosto a mbulohet nga Komuna apo nga Ministria.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** përgjigje parafolësit, rreth çështjeve tjera sigurisht që do të diskutojmë në seancë të Kuvendit ku edhe besoj se do të jepen sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim*

## **2. Propozimi Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2020**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoj, komisioni është caktuar që ishim caktuar në seancën e kaluar, si komision për përgatitjen e këtij plani jemi ulur, kemi diskutuar dhe kemi vendosur në mënyrë unanime për secilën pikë, mirëpo nëse keni ndonjë propozim, sugjerim apo vërejtje urdhëroni.

**z.Fitim Haziri,** pyetje kryesuesit, a ju janë përgjigjur drejtorët e Drejtorive për atë që kanë planifikuar ata për vitin 2020, në mënyrë që ato planifikim të përfshihen si pika në rend të ditës.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** përgjigje, unë i kam njoftuar të gjithë drejtorët e Drejtorive me kohë që plani i punës do të përgatitet, një pjesë e tyre janë përgjigjur dhe i kanë dërguar temat/propozimet që i kanë të parapara dhe obligative sipas ligjit, kurse të tjerët i dinë vetë.

**z.Fitim Haziri,** theksoi, e parashtrova pyetjen paraprake sepse në planin e më hershëm ne vet që i kemi fut të gjitha ato pika dhe i kemi votuar në Kuvend kanë kaluar nga të gjitha grupet parlamentare, por nëse e bëjmë një analizë sa janë zbatuar ato pika që ne i kemi futë vërejmë se shumica e atyre që janë paraparë të diskutohen nuk kanë ardh në seanca. Tani ne nëse po votojmë diçka dhe e miratojmë duke e ditur rëndësinë që Kuvendi Komunal është organi më i lartë i Komunës dhe na po i votojmë atëherë kush po e merr përgjegjësin e zbatimit të atij vendimi që ne po e bëjmë. Ato vendime duhet të zbatohen edhe nga Kryetari, drejtorët dhe të gjithë, dua të them se aty kemi bërë shkelje ngase nuk është zbatuar plani në shumicën e rasteve sepse nuk kanë ardh ato pika, dhe tani nëse i vendosim si pika dhe marrim vendim por që nuk zbatohen, atëherë nuk e di ku e ka seriozitetin Kuvendi si Kuvend.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, për planin paraprak të punës, përkatësisht për punën e Kuvendit për vitin 2019, ne së shpejti do e kemi raportin përkatës dhe do të mund të shohim sa është realizuar ngase do të paraqiten të gjitha punët dhe aktivitetet e realizuara ku edhe do të kemi mundësi të diskutojmë më gjerësisht për planin e vitit të kaluar dhe realizimin e tij si dhe arsyeshmërinë e realizimit apo mos realizimit të tij.

**z.Faik Muçiqi,** drejtor i DSHPMSH, theksoi, në parim jam pajtuar që secila Drejtori ta ketë nga një informatë dhe kam vërejtur që në planin e punës së Kuvendit, në muajin korrik 2020 ka hyrë si temë/informatë e DSHPMSH për çka edhe pajtohem plotësisht, mirëpo pavarësisht kësaj kam edhe dy propozime për përfshirje në planin e punës së Kuvendit për vitin 2020, dhe atë: -Plani i Mobilitetit, të cilin planifikoj të procedoj në muajin maj, dokument të cilin Komuna e Podujevës planifikon ta miratoj dhe jemi në mesin e katër komunave përfituese për hartimin e tij me GIZ-in Gjerman e që besoj se në muajin maj plani do të jetë i gatshëm. Pastaj është pika tjetër -Propozim rregullorja për transportin rrugor në Komunën e Podujevës, të cilën planifikojmë ta procedojmë në muajin mars, pasi që tani veç ka filluar amandamentimi. Pra kemi këto dy propozime që të përfshihen në planin e punës së Kuvendit për vitin 2020, ndërsa në rast se nuk sjellën në Kuvend, përgjegjëse janë vetë Drejtoritë përkatëse, mirëpo është e rëndësishme të jenë të parapara në plan të punës. Plani i Mobilitetit është jashtëzakonisht i rëndësishëm, e që akter / sponzorizues i tij, krahas DSHPMSH do të jetë edhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Vlen të theksohet se meqë organizata Gjermane GIZ është përkrahëse e këtyre dy dokumenteve qoftë përkrahje financiare por edhe me ekipet këshilluese ekspertësh, ne kemi filluar me takime para një jave, dhe shpresoj se do të jenë dy dokumente të kompletuara.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, konsideroj se këto dy propozime të paraqitura nga drejtori parafolës janë të mirëseardhura fillimisht si dokumente për nga rëndësia por edhe vetëm sa e pasurojnë planin e punës e që shpresoj se do të përfshihen në plan pune për vitin 2020.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, krahas kësaj kishte me qenë mirë të bashkëngjitet edhe Stacioni i autobusëve që do ta lehtëson shumë punën e transportit.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa i përket përgatitjes së propozim planit të punës, të gjitha Grupet e subjekteve politike i kanë pasur përfaqësuesit e tyre në komision. Pas miratimit, besoj në zbatimin e të njëjtit ashtu siç është, dhe që nuk do të largohet ndonjë pikë, mirëpo që nuk do të kishte problem nëse shtohet diçka në plan.

**z.Mirsad Kamerolli**, drejtor i DPZHE, theksoi, sa i përket pikave që mund t'i planifikojmë ne si drejtor të Drejtorive, mund të them se kur ka pika apo projekte që janë të veruara nga Zyra e Prokurimit, paksa është problem ta specifikojmë periudhën kohore se kur mund të planifikohet apo futet në plan të punës.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa i përket kësaj që drejtori parafolës e ceku, është dashtë të ketë reflektim dhe të sjellët plani i Zyrës së Prokurimit dhe Plani i projekteve proritare, qoftë për Shërbime Publike apo Infrastrukturë, dhe me atë ne do të ecnim para, e them këtë ngase Kuvendi është në dispozicion të Ekzekutivit për t'i legjitimuar gjërat, ato çka janë ligjore. Unë jam në subjektin politik që jemi në opozitë, por në këtë rast mendoj se kështu do të ishte mirë. Ne si kuvend nëse s'kemi plan të Prokurimit dhe Plan të projekteve proritare, që s'pari janë proritare për juve si Drejtori.

Ne duhet të fusim diçka si rend të ditës, ndryshe e vështirësojmë edhe punën tonë edhe të tuajën si drejtor, por si qoftë mendoj, dhe është edhe me ligj që Plani i Prokurimit duhet të sjellët në Komitet për Politik dhe Financa, në mënyrë që të shikojmë dhe analizojmë se cilat projekte, afatet, aktivitetet etj, do të zhvilloj Zyra e prokurimit, pastaj sa janë shumtë financiare, sa janë financat, por që nuk po sjellët një plan i tillë, Kryetari po ashtu nuk ka disponim ta sjellë, kështu që vetëm po diskutojmë në aspektin moral ne këtu, por që si do që të jetë unë jam që të vazhdohet më tutje dhe të përcillet ky plan për seancën e Kuvendit.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, falënderoj për kontributin, meqë nuk ka të lamëruar anëtarë tjerë për të marrë fjalën, dëshiroj të potencoj edhe diçka rreth këtij plani, dhe atë, në përshkrimin e këtij dokumenti, në fillim kemi një pikë ku cekem Planet Zhvillimore Urbane dhe Planet Rregulluese Urbane, andaj do të ishte mirë të korrigojohen sepse me ligjin të ri nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor sipas terminologjisë, ato plane tani quhen Hartat Zonale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me plotësim ndryshimet që në kuadër të Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, të përfshihen:*

*Propozimet e z.Faik Muçiqit, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit*

- *Propozim Rregullorja për transportin rrugor.....muaji mars*
- *Plani i Mobilitetit.....muaji maj*

*Si dhe kërkesa e Kryesuesit të Kuvendit për korrigjimin e emërtimeve të dokumenteve të planifikimit hapësinor, përkatësisht në përshkrimin ku cekem "Planet Zhvillimore Urbane, dhe Planet Rregulluese Urbane", të korrigojohen sipas terminologjisë me Ligjin e ri, përkatësisht Hartat Zonale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme*

### **3. Raporti mbi diskutimin publik të draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës**

**z.Avni Fetahu**, theksoi, propozimet dhe rekomandimet që janë dhënë gjatë diskutimit publik por edhe disa vërejtje që i kemi jap, kam vërejtur se janë përmirësuar, prandaj ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për miratim.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, lidhur me hartimin e këtij dokumenti të Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit, kam pyetje, a ka bërë kompania hartuese ndonjë studim të fizibilitetit në Komunën e Podujevës, sepse shohim se janë paraparë shumë çështje për zhvillimin e turizmit në Komunën e Podujevës, si dhe a ka pasë ajo kompani kapacitete profesionale që ta bëjë këtë studim, e them këtë ngase sa kam informata hartimi i kësaj strategjie ka kushtuar mbi 13.000.00€.

**z.Mirsad Kamerolli**, drejtor i DPZHE, theksoi, kur kemi shqyrtuar draftin fillestar ju kam sjellë edhe propozimet në drafte si dhe e kam cekë që në nivel Kosove është Draft Strategjia dhe është studimi i fizibilitetit për turizmin brenda Komunës tonë e që jemi e dyta në nivel Kosove pas Prizrenit. Unë e di që ka mangësi edhe brenda institucionit sa i përket turizmit në nivel nacional edhe në nivel lokal edhe kompanitë që merren me këtë fushë nuk janë superiore por në bazë të asaj që unë i kam përcjell dhe në bazë të konsultave që i kamë pas me ekspert profesional që janë të kyçur edhe në institucione nacionale, kjo Strategji është më e mira që ka mund ta bëjë, natyrisht duke marrë dhe duke u mbështetë në specifikat e Komunës së Podujevës. E kemi një përshkrim të gjendjes reale në fushën ku mund të zhvillohen aktivitete turistike dhe ku duhet të orientohen investimet në të ardhmen si dhe cili produkt turistik mund të zhvillohet dhe të jetësohet në mënyrë që të jetë profitabil për Komunën në përgjithësi por edhe për operatorët e turizmit të cilët duan të investojnë. Pra po e përsëris sërish, unë bashkërisht me komisionin, që ka qenë për mbikëqyrjen e kësaj strategjie që është e caktuar nga Drejtoria kemi qenë në dispozicion të kompanisë bashkërisht me të gjithë ekspertët e fushës që i ka Llapi nga fusha të ndryshme të turizmit ku janë të specifikuar në draftin fillestar që ju kemi dërguar dhe po besoj që e kemi bërë punën më të mirë të mundeshe.

Me thashetheme apo me rivalitete të kompanive të caktuara nuk merrem as nuk e bëjë avokatin e asnjë kompanie, po ashtu asnjë nga ato pretendime që janë ngritë nga një përfaqësues i një kompanie që ka pasë pretendime për ta përgatitë këtë Draft Strategji, por që në procedura të prokurimit nuk ka dalë me çmim më të lirë, nuk ka mundur ti arsyetoj asnjë nga ato vërejtje dhe sugjerimeve që i ka bërë.

Ku kemi ditë që dikush ka njohuri apo që merret me fushën e turizmit kemi kërkuar të dhëna dhe kemi bërë pyetje, e që nga shumica e tyre kemi marrë sugjerime dhe propozime të ndryshme, kjo vetëm e vetëm që ky dokument të jetë sa më i kompletuar dhe i arsyeshëm, kështu si edhe është, andaj edhe po besoj që është dokumenti më i miri në nivel të Kosove sa i përket turizmit.

**z.Fitim Haziri**, pyetje, a ka ndonjë ujëvarë Komuna e Podujevës, ngase në draft është e cekur një ujëvarë në të cilën duhet të bëhen investime.

**z.Mirsad Kamerolli**, drejtor i DPZHE, theksoi, Komuna e Podujevës i ka bukurit natyrore që ndoshta për hir të mungesës së investimeve dhe mungesës së specifikimit të tyre, kanë mund që me kalimin e kohës edhe të shkatërrohen dhe të mos iu gjenden fillet e fillimit të tyre, ndoshta edhe Zoti kur e ka krijuar e ka krijuar më mirë në fillimin e vet se sa tash që i kemi pikat e caktuara që janë mbet në mungesë të investimeve.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, ujëvarën s'mundet me ndal askush ajo kur është e rrjedhshme s'mundet me ndal asgjë.

**z.Mirsad Kamerolli**, drejtor i DPZHE, theksoi, unë mendoj që ajo pikë, me investime të caktuara edhe pse s'mundet me pas shumë investime të mëdha, ajo e merr pamjen e një ujëvare, ndoshta jo të përmasave të ujëvarës së Mirushes, por megjithatë është me karakteristika që mund t'i ngjaj një ujëvare, mirëpo ta kemi parasysh që edhe madhësia e ujëvarave ndryshon. Ne duhet t'i specifikojmë dhe identifikojmë si dhe t'i bëjmë sa më madhështore ato që i kemi.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, konsideroj se të gjithë ne duhet të krijojmë mundësi që njerëzit që janë të interesuar të vijnë dhe të investojnë në aspektin e turizmit nëpër këto begati natyrore turistike që i ka Komuna jonë, pra është mirë t'ju bëhet reklamë sepse ka begati që ja vlejnë edhe në nivel nacional.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, është e vërtetë që strategjia si dokument është i pari i këtij lloji dhe nuk po dua të ndalem te kompania sa ka qenë profesionale etj, por mendoj se janë nxjerrë disa pika që edhe ne si qytetar i dimë e që kanë nevojë për investime në mënyrë që të njëjtat të mund të frekuentohen më shumë nga qytetarët dhe turistët. Nuk do të thotë që nuk mund të përfshihet ndonjë propozim apo sugjerim konkret i joni deri në seancën e Kuvendit kur do të del për shqyrtim dhe miratim dhe që i njëjti pastaj të inkorporohet në dokumentin final.

Ka vërejtur edhe propozimet e "Shoqatës Alpiniste Llapi", të cilët sa kam parë anëtarët e të cilës dalin dhe po ecin bjeshkëve, kanë jap edhe disa propozime që të vendosen pika, ndalesa, shtegje apo shtëpi në rajone të caktuara ku mund të ndalen dhe të pushojnë. Unë personalisht pres vetëm sa Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik do të jetë në gjendje të siguroj buxhet për vete si Drejtori në mënyrë që këto pika të cilat janë targetuar t'i bëj funksionale dhe më atraktive që dikush ka dëshirë të vizitoj ato, qoftë një ujëvare që ka fillua të degradohet apo qoftë një shteg i ecjes apo një shtëpi alpiniste. Ne tani hyjmë në vitin 2020, është sezonë e dimrit dhe e dimë që është e pamundur të bëhet diçka në këtë drejtim, por kjo mund të plotësohet në të ardhmen dhe nëse gjendet ndonjë pikë e re.

Është Drejtoria përkatëse ajo që e bashkëngjitet arsyeshmërinë ngase nuk do të thotë që s'ka pas ndonjë pasqyrë Ekzekutivi i Komunës në këtë drejtim, e them këtë ngase disa çështje i dinë këta shumë mirë dhe këtë e bazoj edhe në bazë të bisedave spontane private që bëjmë.

Si do që të jetë unë e lus drejtorin e DPZHE, të gjitha këto pika që janë paraparë, duke mos përjashtuar edhe ndonjë pikë tjetër, të bëhet përpjekje maksimale dhe të mundoheni t'i funksionalizoni, të kërkoni buxhet për objektin në Bellasicë, shenjëzimin e shtegut përkatës si dhe çështjet tjera të parapara në këtë dokument. Pastaj do të ishte mirë të përgatitet edhe një hartë e cila do të site e qasshme edhe për opinionin publik sipas të cilës do të jepeshin edhe koordinatat e pikave interesante që janë, dhe e njëjta të plasohet në ueb faqen e Komunës, dhe më gjerë. Unë e mbështesë dhe pres që të filloj të bëhet diçka në këtë drejtim nga ana e Drejtorisë përkatëse.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, në dokument është cekur që janë disa ujëvara, një në fshatin Popovë dhe një në Muhazob, andaj përderisa janë në cekur në dokument besoj që mund të arsyetohen dhe i plotësojnë ato kushte dhe kriteret të jenë ujëvara.

**z.Mirsad Kamerolli**, drejtor i DPZHE, theksoi, ajo çka nuk e ceka në fillim është se për dokumentin e Strategjisë në fjalë ka pasur një konsultim me bazë të gjerë të opinionit publik në secilin lokalitet.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës, përfshirë edhe raportin në fjalë, me obligim që Raporti në fjalë t'i bashkëngjitet konstatimeve të rekomanduara nga kjo mbledhje e KPF-së, në mënyrë që këshilltarët e Kuvendit të kenë mundësi dhe kohë t'i analizojnë para mbledhjes së Kuvendit.*

#### **4. Raporti dhe rekomandimi i Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc**

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, theksoi, unë në pika të shkurtra paraqita një fjalë hyrëse në fillim të kësaj mbledhje, mirëpo pavarësisht asaj edhe njëherë dëshiroj ta specifikoi çështjen kur ishte fjala tek rregullorja për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, në nenin 8 pika 2, thuhet, kushtet, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive të përcaktohen me kontratë të veçantë mbi bazën e rekomandimit të komisionit, dhe kjo ka qenë fjalja që na ka nxitë ta dërgojmë këtë dokument. Pra kemi një rekomandim të komisioni, një raport - rekomandim dhe të hartojmë kontratën e shfrytëzimit për këtë kategori të veçantë banimi. Sipas kësaj do të thotë që komisioni i ngritur nga Kuvendi i Komunës i kalon kompetencat e DSHMS e që për mendimin tim tani në këtë rast ka fuqi më të madhe juridike në kuptimin e asaj që kalon kompetencën tonë si DSHMS sa i përket nxjerrjes së ndonjë akti apo ndonjë veprimi pa rekomandimin e tyre.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, nuk e di kush e ka bërë dokumentin të cilin e ceku drejtori, dhe tani drejtori fol për një dokument që nuk e di se kush e ka miratuar apo nxjerrë.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, theksoi, dokumenti në fjalë është nxjerrë me 27 maj 2014, Kryesues i Kuvendit ka qenë z.Mehmet Gashi dhe kjo rregullore është e bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për financimin e programit të veçante të banimit dhe me Statutin e Komunës.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, i nderuar drejtor tani ju jeni pjesë e administratës komunale, çdo vit në Kuvend miratohen, rregullore për tatime, rregullore për komisione të ndryshme, bëhen plotësi ndryshime të legjislacionit apo ligjit, udhëzime administrative, andaj absolut nuk jam kundër kërkesës së komisionit, por mendoj se duhet të shfuqizohet ai dokument i miratuar më herët në Kuvend.

Kur kemi pasë në shqyrtim dhe miratim vendimin për tatime dhe qira, e kemi potencuar që këtu të mos futet Lagjja e Dëshmorëve, kemi diskutuar për këtë çështje dhe s'ka pas disponim, kjo është e vërteta, nuk e di a ka qenë drejtori i DSHMS në seancë apo jo sepse nganjëherë po mungoni në seanca dhe prandaj ju mungon informacioni adekuat, dua të them se ka pasur disponim të hiqet Lagja e Dëshmorëve sepse kemi thënë që ato familje dhe ai kamp nëse mundem ta quaj kështu, është ndërtuar për shkak të kushteve specifike familjare, dhe tani është në fuqi rregullorja për pagesën e qirasë para tri-katër seancave kur është miratuar, kurse tani duhet të shfuqizohet propozim vendimi i Kryetarit për taksën apo marrjen e qerasë, duhet të harmonizohen të gjitha kontratat nëse merret vendim i ri për lirim, sepse tani s'po di qysh i keni bërë kontratat sepse kontrata nënshkruhet në mes të Kryetarit dhe shfrytëzuesit të banesës, ndërsa ju i keni nda mbi 70 shtëpia dhe ato kanë kontratë adekuate që nuk është ky pasus.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, nuk di që ka ndokush kontrata të lidhura me Komunën nga familjet që jetojnë në Lagjen e Dëshmorëve.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, nëse nuk kanë kontrata, atëherë ju pyes drejtor, si kanë hy dhe si i shfrytëzojnë ato shtëpi ata persona.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, theksoi, shfrytëzuesit e atyre shtëpive kanë një dokument por që nuk është kontratë. Ligji e përcakton që duhet të nxirret një kontratë por deri më tani ata nuk kanë kontratë.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sipas asaj që drejtori e potencoj do të thotë që vet ai nuk e ka kryer punën e vet si drejtor që është, por nuk e ka kryer punën si duhet as komisioni për ndarje e shtëpive në atë lagje. Kemi të bëjmë me fazën e tretë të ndarjes së shtëpive, pra tani ne po flasim për një qasje që ju nuk e keni kryer punën e juaj. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për ndarjen e shtëpive është për ndarjen e shtëpive kurse Ekzekutivi është ai që i përcakton a të lirohet apo jo dikush nga tatimi sipas



ligjit në fuqi ndërsa tani dikush po e thotë që komisioni duhet të sjellët Kuvend për arsye që mos ta mbaj barrën vet, e që sipas kësaj po del që Komisioni nuk e njeh as kompetencën e vet brenda ligjit.

Unë nuk jam që të lirohen por është dashtë të përgatitet me material sepse kur nënshkruhet kontrata mes Kryetarit dhe një qiramarrësi, qoftë të dhënies së pronës publike apo të shtëpive në fjalë, askush nuk njoftohet çfarë përmbajnë kushtet e asaj kontrate, kjo është shumë e vërtetë, madje as drejtori i DSHMS nuk i din, me cilat kushte e ka lëshua Kryetari i Komunës kontratën me një qiramarrës dhe me cila specifika është nënshkruar.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, theksoi, unë isha shumë i qartë kur e thash që nuk jam në dijeni se ka të nënshkruar ndonjë kontratë mes Komunës dhe shfrytëzuesi në atë Lagje, dhe të njëjtën gjë po e përsërisë sërish, nuk e di që ka kontratë, nëse parafolësi e dinë ta thotë cila është ajo.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, vetë ju drejtor po thoni që duhet të nënshkruhen kontratat me shfrytëzuesit e shtëpive në atë Lagje.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, sqarim shtesë parafolësit, ne nuk e kemi bërë kontratën, kontrata bëhet në bazë të rekomandimit të komisionit, ne nuk e kemi këtë rekomandim, ju keni mundësi që komisionin ta dëgjoni çfarë ka rekomanduar.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, para sa muajve ky komision në krye me Agim Behlulin dhe i përbër prej subjekteve politike, i kanë ndarë shtëpitë, sa më kujtohet janë rreth 8 muaj prej që janë ndarë 20 shtëpi, kurse tani është sjellë lista, me një ankesë, e cila është shtyrë për tre muaj deri sa e kanë shqyrtua komisioni i ankesave. Ti drejtori (i drejtohet drejtorit të DSHMS), po harron krejt çfarë është punuar para rreth katër muajve e që nuk po dëshiroj të ngrisë temë për debat por po dëshiroj të tregoj se para rreth katër muajve, i njëjti komision me të njëjtën përbërje politike si dhe i njëjti drejtor i DSHMS, e ka sjell listën që i ka ndarë shtëpitë, ka pasë një ankesë në atë ndarje sepse ka qenë pjesë e debatit në këtë zyre dhe nuk është mbledh komisioni për ankesa tre-katër muaj, mirëpo pas mbledhjes sërish kanë mbetur të njëjtit. Ti nëse je emëruar Drejtor i ri i DSHMS, pasimi i administratës dhe përcjellja e legjislacionit në Drejtorinë përkatëse bartet në detyrë dhe funksion. Pra ato shtëpi që janë ndarë në mandatin e i sh drejtorit z.Agron Hyseni mbeten barrë e atij që është në funksion sepse duhet të vazhdojnë procedurat administrative, madje ka Komuna ku ka ndërruar komplet pushteti tek një subjekt politik tjetër, mirëpo dokumentet mbesin aty.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, edhe një sqarim shtesë, në vendimin për ngritjen e komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, neni 4 thotë: “Kriteret e ndarjes, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive dhe çështjet tjera përcaktohen me akt të veçantë të Kuvendit” , këtu nuk po thotë të Drejtorisë, përkatësisht thuhet, me rregulloren e Kuvendit të Komunës për caktimin e kriterëve për dhënien e shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve". Tani rregullorja i jep disa çështje, shembull po e cekë një detaj, neni 3 thotë, shtëpia e dhënë në shfrytëzim është aset i Komunës dhe shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta tjetërsoj.

Pastaj edhe njëherë, në nenin 10 pika 2 thuhet, kushtet, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive të përcaktohen me kontratë të veçantë mbi bazën e rekomandimit të komisionit, prandaj i nderuar këshilltar, ne nuk po zbulojmë asgjë.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, unë shpesh herë kam qenë kundër disa vendimeve dhe kam votuar kundër, mirëpo edhe po të ishte drejtor i subjektit tim, apo edhe kryetar i partisë ku jam unë, në qeverisje ku do të isha unë në nivel komune, propozimet për prona publike të bëra nga një komision prej tre anëtarëve, nuk do t'i mbështetja.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, komisioni nuk përbëhet prej tre anëtarëve por ka pesë anëtarë dhe është gjithëpërfshirës, madje është edhe anëtari nga subjekti juaj politik i nderuar Llapashtica e që në fakt ai zërin tënd e tregon atje në Komision.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, për herë të parë po dëgjoj prej teje drejtor, që ndahen 20 shtëpi në mënyrë shumë të drejtë. Nuk dëshiroj të ndërhyj në komision dhe i besoj komisionit, kurse ti je drejtor aktual edhe e din se vet e ke futë në pasus këtë çështje, ngase kur është bërë plani për taksa është dashtë të ndërhyhet, ti është deshtë të jesh më i zëshmi në Kuvend dhe ta thoni skemën sociale, mandej ndihmat sociale për jetës duhet t'i lironi prej takse, por ti drejtor ke qenë kundër aty dhe nuk keni qëndruar në seancë fare.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, sërish sqarim parafolësit, po dëshiroj t'jua përkujtoj një detaj dhe t'ju tregoj, aty në atë Lagje kemi shokë tuaj të cilët e marrin pagën 1000 €, dhe e thoni që me çdo kusht të jenë banorë i asaj Lagjeje. DSHMS apo unë personalisht mund të thirrem në listën e atyre anëtarëve që janë në kuadër të skemës sociale, ndërsa jo për punëtorët që i kanë pagat 1000 €, çështje për të cilën nuk mund të bie në kundërshtim me ligjin, kur ligji është i aprovuar. Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit i rregullon specifikisht çështjet e kësaj natyre, madje me pika të veçanta dhe specifike ku bëhet përcaktimi i qirasë, neni 9.

**z.Rafet Llapashtica**, pyetje drejtorit, nëse është i përcaktuar ashtu siç e thoni ju, a po e shkel ti ligjin drejtor.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, unë vetëm mund të propozoj.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, drejtori po e thotë, ne propozojmë kurse ju (ne) e miratojmë, ndërsa drejtori po harron që ai e ka sjellë këtë pikë të rendit të ditës, andaj sa dhe si është ai vetë për dhënien e atyre pronave ta jap propozimin vetë ai (drejtori), ti jepe propozimin tënd sepse piken e rendit të ditës ti e ke sjell këtu, nuk e kamë sjell unë.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, theksoi, qëllimi është të jepet në shfrytëzim afatgjatë, apo deri sa ta ndërrojnë statutin e vet social.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, nuk mund të ketë ashtu siç po e thot drejtori, ose është shfrytëzim afatmesëm ose shfrytëzim afatgjatë, ose 40 vite ose 99 vite.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, ky është program i veçantë i banimit, ky ka dallim prej asaj 99 vite.

Sinqerisht ja kam lakmi parafolësit që mendon se i din të gjitha, por edhe po i admiroj të gjithë të tjerët që ty po të japin hapësirë që t'i tregoj të gjitha çfarë dinë.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ju drejtor i DSHMS jeni të pa përgatitur, madje je out krejt dhe nuk je në ngjarje absolutisht, as me ligjin as me Drejtorin tënde.

Mirëpo e kaloni këtë pikë sepse ne të gjithë jemi tolerant.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, kjo është pikë / temë e Kuvendit sepse komisioni është i themeluar dhe me përbërje nga anëtarët e Kuvendit.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, a mund ta dijë kush e ka sjellë këtë pikë të rendit të ditës, e them këtë sepse Kuvendi nuk sjell pika. Keni pranuar listën finale të ndarjes së shtëpive i nderuar drejtor, e që janë bërë rreth 2 javë, kurse piken në fjalë e keni sjellë sot në Komitet për Politik dhe Financa.

**z.Mehmet Gashi**, theksoi, fillimisht dëshiroj t'ju tregoj se edhe debati ka një rregull, ju lutem, kur të merr njëri fjalën tjetri e dëgjon. U përmend vendimi që është marrë në mandatin e kaluar dhe i nënshkruar nga unë në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit, një vërejtje po jap si të përgjithshme, çdo material që vjen në Kuvend dihet si vjen, me kohë e propozon Drejtorja apo Kryetari i Komunës në emër të Ekzekutivit, zyra ligjore e kontrollon atë material a është në harmoni me ligj, janë dispozitat ligjore pastaj janë nenet përkatëse si propozohet dhe procedohet ai material, vjen në KPF, shqyrtohet dhe rekomandohet apo jo në Kuvend. Unë e di që atëherë materiali është propozua nga Drejtorja apo nga Ekzekutivi, është miratuar ashtu qysh është kërkuar, dhe ai material ka shkuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe është vërtetuar që është i ligjshëm.

Pra ashtu është propozuar, ashtu është miratuar në Kuvend dhe tani ne nëse dëshirojmë të bëjmë ndonjë ndryshim duhet nga Ekzekutivi të sjellët si propozim para mbledhjes së Kuvendit, pastaj është Kuvendi ai që e shqyrton dhe nëse e sheh të arsyeshme e miraton.

Sot e pranuar një propozim të tillë si çështje urgjente që të hy në rend të ditës, por herëve tjera duhet të shkohet me procedura të rregullta, shtatë ditë më herët të dërgohet materiali në mënyrë që të analizohet nga anëtarët e Kuvendit se çfarë vendimi duhet të marrim, pra ka kohë të mjaftueshme dhe mund të merret një vendim të ligjshëm. Nëse shkojmë vetëm në këtë formë, unë nuk besoj që mund të marrim ndonjë vendim të mirë, përndryshe me vendime jo në rregull mund të na kthehen nga Ministria sepse nuk është përfillë baza ligjore.

Nuk e di si u kuptova, vetëm se unë si kryesues nuk kisha lejuar material pa u sjell me kohë vetëm në rast kur është e qartë krejt. Draft Strategjia është e DPZHE dhe ne e pranuar sepse ka qenë edhe në diskutim publik, por edhe atë ditë u dakorduar që nëse e zëmë afatin duhet ta sjellim në KPF dhe kështu ndodhi, materialin e kem përpara dhe ajo nuk ka pengesa.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, është fat i mirë që Ministria përkatëse shikon dhe vlerëson çdo vendim të Kuvendeve të Komunave sa i përket harmonizimit me legjislacion dhe procedural dhe nëse ka shkelje apo tejkalime ato vendime kthehen prapa për rishqyrtim nëse janë në rregull vazhdojnë me zbatim. U fol për materiale, ne të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe kemi qenë pro thirrjes së kësaj seance me datën 05, arsyeja ka qenë që të bëhen 12 seanca dhe të bëhen pagesat për të 12-at, si dhe natyrisht kemi qenë të vetëdijshëm se në këtë seancë ndoshta do të rrjedhin pika të përshpejtuara dhe pa materiale të duhura. Ne e rekomanduar si pikë të rendit të ditës këtu për KPF, kërkuam nga drejtori i Drejtorisë përkatëse që të përgatit një arsyeshmëri dhe të shohim pastaj.

Unë personalisht mendoj që vendosja e atyre familjeve nëpër shtëpia në Lagjen e Dëshmorëve është çështja më urgjente, më domethënëse, më e domosdoshme. Ne të mos gabojmë ligjërisht, por tu jepet mundësia e vendosjes nëpër shtëpitë e reja të banimit, natyrisht duke mos bërë shkelje ligjore. Unë besoj që drejtori ka sjellë një arsyeshmëri që nuk ka shkelje ligjore, të vendosen me kohë dhe të pajisen me dokumente përkatëse për ato shtëpia sepse e kemi njëherë nga pikat më të ndjeshme për qytetar që 20 vite, andaj të bëjmë përpjekje që të largohen nga ata kontejnerë njëherë e përgjithmonë sepse gjithëherë e kemi pas breng dhe më në fund erdhi koha dhe momenti, është ofruar kjo skemë e përgjithshme që ato familje të hiqen nga ata kontejnerë dhe të vendosen në shtëpi të reja.

**z.Rafet Llapashica,** theksoi, nuk është qëllimi fare të vendosen ato familje nëpër shtëpi të reja sepse edhe po që se dëshirojmë nuk mund t'i ndal fare askush që të vendosen aty. Ato shtëpia që ndërtohen aty, janë për banorët të cilët kanë vendim qysh në themelimin e ndërtesave në atë Lagje edhe kur kanë qenë në kontejnerë dhe janë të ndamë me kategori, ata kanë vendim sepse ata kanë shkuar aty pasi që i ka shkatërruar lufta e fundit në Kosovë, s'kanë pas ku të vendosen dhe ai donacion që ka ardh ato familje janë vendosë.

Ne ishim duke diskutuar sepse drejtori i DSHMS e tha që do të nënshkruhet kontratë me shfrytëzuesit e shtëpive, ndërsa ligjin e ka paravetës dhe këtë çështje si pikë të rendit të ditës e ka propozuar po ai vet e jo siç e ceku kinse kjo pikë është e Kuvendit. Kuvendi i Komunës nuk sjell pikë të rendit të ditës, problem kam me ta shpjeguar proceduralisht, në procedurë administrative. Problem tjetër drejtori e ka sepse e ka sjell propozimin e komisionit, ai komision listën me 20 përfitues të shtëpive nuk ia ka sjell tani, por atë listë e ka dorëzuar më herët. Edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e kemi përfaqësuesin tonë në atë komision dhe është dashtë të ketë propozim qysh më herët dhe të sjellët së bashku me material - raporti i komisionit, që ne pastaj me ditë çka të debatojmë në KPF dhe Kuvend në mënyrë që të marrim vendim qoftë për qiranë qoftë për çështje tjera, përndryshe pikën rreth qirasë për ata shfrytëzues të shtëpive, dikush duhet ta shkel, ose ti drejtor ose ne, sepse e specifikon ligji, ato familje nëse nuk mund të lirohen nga ti si drejtor, nuk mund të lirohen as nga ne si Kuvend, mirëpo nëse caktoni

taks minimale të qirasë, qoftë edhe 0.01 cent që do të bënë ndoshta brenda një viti 1€, ajo është diçka tjetër, atë pasues nuk e kamë nxjerr unë por faktikisht ai pasues nuk është për skema sociale.

Në seancë kur është miratuar pagesa e taksave ti drejtor nuk ke qenë fare prezent, ti drejtor nuk ke luftuar fare për skema sociale në seancë, edhe nuk keni dijeni për familjet me skemë sociale në Podujevë se cilat janë ato, madje nuk keni dijeni sa e ke marrë përqindjen e skemës sociale nga ish drejtori i DSHMS-së, sa e ke zhdukë ose sa e ke ngritë atë kategori, nëse mundesh me na jap një raport jepna. Nuk po dëshiroj të flas politikisht, por më tregoni, shembull me kaq e kam pranuar skemën sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kaq e kam zhduk ose kaq është ngritë, pastaj cekni edhe arsyet dhe jemi në rregull pastaj, por ti dinë të thuash vetëm çka ka thënë Agimi dhe çka ka thënë komisioni. Një propozim na e ke sjell këtu, unë atë nuk e pranoj ashtu qysh ti mendon, madje po të ishe edhe drejtor nga subjekti im politik për arsyeje se mban përgjegjësi institucionale të paktën, mirëpo diplomat atje janë të gjithëve atje që kanë kryer shkollë, edhe e jotja që je me fakultet dhe drejton një Drejtori, por kjo çështje siç po sjellët proceduralisht, më bënë skeptik rreth shkollimit tuaj drejtor.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, unë edhe njëherë po ta përsërisë atë që e ceka më parë, ju kam lakminë që gjithë këto fjalë po mundesh me i folë edhe absolutisht nuk kuqesh prej marreje.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, kur të dëshironi drejtor, madje edhe në seancën e Kuvendit në prezencë të të gjithëve, debatojmë për skemën sociale, për Lagjen e Dëshmorëve, për gjendjen në shëndetësi.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, theksoi, nuk është obligim i drejtorit të DSHMS që t'i nxjerrë peronat apo familjet nga skema sociale, politika tjera janë ato, por ti (i drejtohet parafolësit) aq po mundesh me thënë edhe po fol.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, “luftë” është bërë prej Ekzekutivit me hy një anëtar aty në komision, nuk ka komision që e ndërton Kuvendi pa qenë një anëtar ose shumicë Ekzekutivi i Komunës sepse është ai që qeverisë me Komunën e jo Kuvendi.

I nderuar Kryesues unë po e di që këtë debat po e toleron për hir të situatës, mirëpo mos mendoni që Kuvendi dhe anëtarët e tij nuk dim aq shumë sa të lëshojmë gjëra të dalin në këtë kategori.

Propozimin ta sjellë drejtori i DSHMS, e jo të thotë e ka sjellë komisioni.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, përgjigje, ligji dhe rregullorja përkatëse e përcakton se komisioni sjellë propozime, rekomandime etj..

**z.Rafet Llapashtica**, përgjigje, atëherë përse nuk ia lë komisionit që në seancën e Kuvendit ta sjellë, por ke sjell ti si drejtor i DSHMS. Pastaj përse po thoni nuk është detyrë e drejtorit, dhe njëkohësisht po kryeni detyrat e dikujt tjetër.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, përgjigje, me rregullore thuhet se komisioni duhet ta bëjë një gjë të tillë, unë kërkova nga komisioni, por mua më rekomanduan që ta bëjë unë sot këtu në KPF, kjo ishte arsyeja sepse komisioni nuk mund ta bëjë një gjë të tillë në këtë komitet.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, vetë fakti që komisioni këtë punë ja ka dhënë drejtorit të DSHMS tregon që kjo punë është detyrë e po kësaj Drejtorie. Pra kjo punë edhe kjo çështje lidhet direkt me emrin e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, përgjigje, fakt që çështja në fjalë lidhet me DSHMS, prandaj edhe jam këtu dhe do të mundohem të jap kontributin tim.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, nuk e kam të qartë çfarë jemi duke propozuar, andaj edhe po kërkoj të qartësohemi. Komisioni ka një mandat të caktuar, por jo edhe gjitha kompetencat për këtë çështje, dhe i njëjti mund të del ta thotë fjalën e vetë në seancën e Kuvendit. U përmenden vendimi dhe kontrata e që ne kemi nevojë të qartësohemi edhe më shumë sepse ka specifika në këtë çështje. Ne e dimë që çdo herë komisioni i ka jap rekomandimet, drejtori del me një propozim konkret. Nëse drejtori në fjalë mendon që ka të drejtë, atëherë ta mbron atë të drejtë, të kthehet ta pyet zyrën ligjore apo kë do qoftë, dhe do të shohë që se ka të drejtë ashtu.

Komisioni i rekomandon DSHMS, por drejtori i kësaj Drejtorie duhet të dal në seancën e Kuvendit me një propozim konkret, qoftë edhe sipas rekomandimit të komisionit, por që ti drejtor duhet të dalësh me propozim konkret sepse ti ke në menaxhim atë fushë dhe po ti drejtor do të lëshosh vendimin apo kontratën, si duash emëroje, pastaj ti drejtor do të menaxhosh punën se kush del prej aty dhe kush hyn. Dua të them se nuk mundesh me i ik përgjegjësisë dhe përderisa nuk mundesh me i ik përgjegjësisë duhet të dilni me një propozim. Pres që në seancë drejtori i DSHMS të dal me një propozim, pastaj ne të vendosim a po e përkrahim apo jo.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, i nderuar drejtor i DSHMS, propozim vendimin që e sjell Kryetari i Komunës, pastaj kemi propozimi i komisionit dhe propozimin tënd që duhet të bëhen. Kryetari i Komunës është shefi këtu, dhe ai sjell propozim vendime dhe pika tjera për Kuvend përmes drejtorëve të Drejtorive, natyrisht konform ligjit e që as unë as ju se keni nxjerrë por dikush tjetër. Prandaj mos më sjellni propozim të komisionit, por sjellni propozim tuajin si drejtor i DSHMS-së, kjo është procedura. Konsultohu me ligjin që përcakton qiranë e banimit dhe gjitha aktet tjera përkatëse dhe në seancën e Kuvendit na thoni në mënyrë të specifikuar dhe kaq, jemi në rregull dhe na do ta mbështesim.

**z.Zaim Thaqi**, drejtor i DSHMS, theksoi, o i nderuar komisioni rekomandon, jo ne, vet ju si Kuvend i keni dhënë mandat të tillë me rregulloren përkatëse.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, si të dëshironi drejtor, ti vetëm thuaje që do ta arsyetosh rekomandimin e komisionit.

*Pas diskutimeve dhe sqarimeve të dhëna, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me obligim që Konstatimeve nga kjo mbledhje e KPF-së ti bashkëngjitet në formë të shkruar Rekomandimi i Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, i paraparë në Rregulloren e Kuvendit të Komunës së Podujevës për caktimin e kriterëve për dhënien e shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc, konkretisht sipas nenit 10.2, ku thuhet: (Kushtet, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive përcaktohet me kontratë të veçantë, mbi bazën e rekomandimit të Komisionit).*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:50**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr.01-016/01-0091350/19  
Podujevë,  
03 dhjetor 2019**

**Kryesuesi i Komitetit  
Fatmir Gashi**